

SHPALLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**Forca Ajrore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
1	Specialist për infrastrukturën	Reparti ushtarak nr.3002, Forca Ajrore	Rinas, Tiranë.	E Pacaktuar	Me dosje	Inter vistë	13.03.2018	28.03.2018

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës:	Specialist për infrastrukturën
2. Kodi i pozicionit:	C2
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr.3002, Forca Ajrore
4. Vendi:	Rinas, Tiranë
5. Paga:	VKM Nr.202 datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.717, datë 23.06.2009 Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i nrdyshuar, Lidhja II, II/1 me Klasën IX, (36.000). Urdhërit të MM nr. 1706, datë 13.10.2015 “Për shtesë mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin” I/d, II/f (5340).
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit:	18.03.2018
8. Data e mbylljes së aplikimit:	28.03.2018
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:	<p>a. Grada/Titulli: Civil me arsim të mesëm.</p> <p>b. Arsimi : Mesëm profesional (ndërtim).</p> <p>c. Kualifikimi: Të ketë eksperiencë pune si teknik ndërtimi.</p> <p>Të ketë aftësi të mira organizuese, komunikuese dhe prezantuese.</p> <p>d. Trajnimi: Të ketë kryer trajnime të ndryshme në lidhje me specialitetin e kërkuar.</p> <p>e. Eksperienca në Punë: mbi 3 vjet.</p> <p>f. Gjuha angleze: 2/1/2/1</p> <p>g. Kërkesa të tjera specifike: Përdorim të programeve bazë të kompjuterit.</p> <p>h. Niveli i certifikatës së sigurisë: I kufizuar</p>

11. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: Organizimi dhe koordinimi i punës për kryerjen e inventarizimit dhe njohjen gjendjes së ndërtesave, objekteve, ambjenteve të brendshme dhe të jashtëme si brenda dhe jashtë planit të përhapjes.

Informon Komandantin mbi gjendje fizike të objekteve dhe ndërtesave në inventar të Forcës Ajrore.

Ndjek punimet dhe harton preventive për punën që do të kryhet në ambjentet e infrastrukturës së repartit.

Harton dhe përpilon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas normave dhe legjislacionit në fuqi.

Ndjek në çdo kohë zbatimin e urdhërave e udhëzimeve, evidentimin e problemeve të infrastrukturës dhe bën propozimet përkatëse tek Komandanti i kompanisë.

Kryen detyra shtesë në përshtatje me nevojat e shërbimit kur kërkohet nga eprori.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për gjendjen, plotësimin e dokumentacionit dhe inventarizimin e objekteve dhe infrastrukturës së Forcës Ajrore, brenda dhe jashtë planit të përhapjes.

12. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

Dokumentat e aplikimit per pune:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm:

- Kërkesën personale;
- Formularin e aplikimit;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dëftesë e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin;
- Diplomë e arsimit të lartë/liste notash të noterizuar me origjinalin;
- Fotokopje të patentës nëse ka;
- Dëshmi profesioni nëse ka;
- Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja;
- Raport mjekësor;
- Fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga gjykata;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Librezë pune;
- Jetëshkrimin (CV).
- Formularin e vetëdeklarimit.